



## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër:

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 636-19-5225-5-1-1

Sa i përket tenderit për Ndërtimi i rrugës Junik-Gjeravicë

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

"ARFA GROUP" sh.p.k. & "EUROASPHALT" sh.p.k.  
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Deqan, Gjakovë

(Adresa)

Deqan

(Vendi)

00383.49505091

(Numri Telefonit)

14000

(Kodi postar)

(Numri i Faks-it)

Fadil Hadergjoni

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

ntshnarfa@hotmail.com

(Adresa elektronike)

16.02.2020

(Data e parashtrimt të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

#### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtoj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

\_\_\_\_\_  
(Emri i avokatit)

\_\_\_\_\_  
(Adresa e plotë)

\_\_\_\_\_  
(Numri i Telefonit)

\_\_\_\_\_  
(Numri i faks-it)

\_\_\_\_\_  
(Adresa elektronike)

\_\_\_\_\_  
(Data e parashtrimit të ankesës)

\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Data e njoftimit të kontrates: 18.07.2019  
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave: 26.08.2019 ora 14:00  
Kriteri për dhënien e kontrates: Çmimi më i ulët  
Njoftim për dhënie të kontrates 18.09.2019  
Pezullim i aktivitetit :24.09.2019  
Njoftim për dhënie të kontrates 03.10.2019  
Pezullim i aktivitetit :04.10.2019  
Njoftim për dhënie të kontrates 12.11.2019  
Pezullim i aktivitetit :18.11.2019  
"Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit" 29.01.2020  
Pezullim i aktivitetit : 03.02.2020

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☐

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet**

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po

☒

Jo

☐

**6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po

☒

Jo

☐

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.*

**7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Neni 1 LPP-se  
Neni 6 LPP-se  
Neni 7 LPP-se  
Neni 59 LPP-se  
Neni 60 LPP-se  
Neni 62 LPP-se  
Neni 72 LPP-se  
Neni 44.5 LPP-se



*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

AK me dt. 27.01.2020 na ka dërguar letrën standarde për tenderues të eliminuar, me arsyetimin se tenderi jonë është administrativisht i papërgjegjshëm, ndërsa e ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se asnjë nga ofertat nuk është e përgjegjshme dhe nuk i plotësojnë kriteret e vendosura siç kërkohen në njoftimin për kontratë dhe tek dosja e tenderit.

Ju sqarojmë se arsyet për eliminimin tonë si ofertë administrativisht e papërgjegjshme janë të pa bazuara sepse ne i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe tek njoftimi për kontratë dhe gjithashtu jemi operatori ekonomik më i lirë.

AK duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Gjithashtu ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, duke u diskriminuar ne si kompani e përgjegjshme dhe me çmim më të ulët në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së. Gjithashtu në këtë aktivitet të prokurimit, duhet respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, konform nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Sa i përket arsyeve për eliminim ku e keni cekur se:

1

1. "Partneri juaj nuk i ka përmbushur kërkesat e përshtatmërisë".

- Sa i përket arsyes së lartë cekur nuk qëndron për faktin se dokumentet e kërkuara janë paraqitur sipas kërkesës për informata shtesë nga autoriteti kontraktues dhe të njëjtat duhet të kërkohen për fituesin e tenderit me kërkesë të Autoritetit Kontraktues.

2. "Grupi i Operatorëve ekonomik "ARFA GROUP" SH.P.K. dhe "EUROASPHALT" SH.P.K. nuk e plotëson kërkesën me nr. 3, të pikës III.2.3, Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar të paraqitur në njoftim për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

- Sa i përket kërkesës për mbështetje bankare në vlerë prej: 300,000.00 me arsyetim se nuk është adekuate ky pretendim nuk qëndron për faktin se në letër përkrahje të bankes janë të dhëna të të gjitha vlersimet dhe njëherit thuhet se është aprovuar kërkesa e klientit në shumën prej 750,00.00 që do të thotë konsorciumi "ARFA GROUP" SH.P.K DHE "ERUROASPAHLT" SH.P.K., i ka mjetet të aprovuara 750.000.00 dhe mund ti shfrytëzoj në mënyre të pakushtëzuar.

3."Kërkesat me nr.1,4,8,9 dhe 10, të pikës III.2.4., Kapaciteti teknik dhe profesional siç është kërkuar nga Autoriteti kontraktues në njoftimin për kontratë dhe tek dosja e tenderit".

- Sa i përket kërkesës 1 të Kapaciteti teknik dhe profesional ku lideri duhet të posedoj kontrata të përfunduara gjatë 3 viteve të fundit nga data e publikimit për kontratë jo më pak se 60% e vlerës 6,500,000.00 në këtë rast "ARFA GROUP" SH.P.K. e përmbush kërkesën ku kemi 3,920,810.37, punë të ngjashme të realizuara.

#### KONTRATA TË REALIZUARA NË TRE VITET E FUNDIT

Nr.	Emri i projektit	Investitori	Punëkryesi	Viti	Vlera
1	Asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Treboviq, Katun i Ri dhe Nabergjan në Komunën e Pejës	Komuna Pejë	"ARFA GROUP" sh.p.k.	Kontraktuar: 13.09.2016 Përfunduar: 27.10.2017	179,890.70
2	Ndërtimi i urës në rrugën Petro Nini Luarasi në Gjakovë	Komuna Gjakovë	"ARFA GROUP" sh.p.k.	Kontraktuar: 10.11.2015 Përfunduar: 2017	67,326.10
3	Asfaltimi i rrugëve në fshatin RADAVC (Rrugët : Elezaj , Dem Aliajaj , Osmon Zekaj , Hetem Fezaj , Hasan Tafa , E Beqirajve, Xhuraj dhe E Minoriteteve ) në Komunën e Pejës	Komuna Pejë	"ARFA GROUP" sh.p.k.	Kontraktuar: 13.09.2016 Përfunduar: 26.10.2017	171,660.00
4	Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Trestenik ( rruga e Berishëve I dhe 2, rruga afër	Komuna Pejë	"ARFA GROUP" sh.p.k.	Kontraktuar: 22.08.2016 Përfunduar:	166,296.90



	varrezave ) dhe Lutugllavë (rruga Trestenik – Lutugllavë dhe rruga Ker Sadria ) në Komunë e Pejës			19.06.2017		
5	Asfaltimi i rrugëve Hysni Rama dhe Mihajlo Pupin si dhe anekset e rrugës Beteja e Koshares , Ruzhdi Haxhi 3 (anekse) dhe asfaltimi i disa rrugëve në Komunën e Pejës	Komuna Pejë	"ARFA GROUP" sh.p.k.	Kontraktuar: 05.10.2016  Përfunduar: 2018	133,362.89	
6	Asfaltimi i rrugëve Mbreti Zog dhe Eliot Engel dhe Kubezimi i parkingut pranë Cerdhës në Pejë	Komuna Pejë	"ARFA GROUP" sh.p.k.	Kontraktuar: 17.06.2016 Përfunduar: 2017	21,727.70	
7	Ndërtimi i Poligoni Sportiv në Shkollën fillore "Bajram Curri" në Strellc të Epërm, Deçan	Ministria e Kulturës dhe Sportit (MKRS)	"ARFA GROUP" sh.p.k.	Kontraktuar: 25.07.2019 Përfunduar: 05.2018	61,935.36	
8	Ndërtimi i mureve Gabion në Autoudhën "Ibrahim Rugova" Lot1 dhe Lot 2	Ministria e Infrastrukturës	"ARFA GROUP" sh.p.k.	Kontraktuar: 23.01.2017 Përfunduar: 2017	284,397.94	
9	Zëvendësimi i rrjetit të ujësjellësit në Shirok	Ministria e Infrastrukturës	"ARFA GROUP" sh.p.k.	Kontraktuar: 16.04.2018 Përfunduar: 07.11.2018	137,408.58	
10	Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Jabllanicë e Leshanit,Kliqinë dhe Leshan në Komunën e Pejës në vazhdim	Komuna Pejë	"ARFA GROUP" sh.p.k.	Kontraktuar: 15.08.2017 Përfunduar: 09.07.2019	174,465.25	
11	Asfaltimi i rrugës Kilaj-Beleg në vazhdim	Kuvendi Komunal Deçan	"ARFA GROUP" sh.p.k.	Kontraktuar: 01.06.2018 Përfunduar: 28.05.2019	95,799.95	
12	Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatin Meqë në vazhdim	Komuna Gjakovë	"ARFA GROUP" sh.p.k.	Kontraktuar: 29.06.2018 Përfunduar: 08.07.2019	106,217.86	

13	Ndërtimi i rrugës Rogovë-Has	Ministria e Infrastrukturës	"ARFA GROUP" sh.p.k.	Kontraktuar: 09.03.2018 Përfunduar: 09.11.2018	103,981.50
14	Asfaltimi i rrugës Bërdosanë-Rezinë	Komuna Gjakovë	"ARFA GROUP" sh.p.k.	Kontraktuar: 29.05.2018 Përfunduar: 01.03.2019	119,831.91
15	Asfaltimi i rrugës Molliq-Potok	Komuna Gjakovë	"ARFA GROUP" sh.p.k.	Kontraktuar: 18.07.2018 Përfunduar: 25.03.2019	37,351.71
16	Ndërtimi-Asfaltimi i rrugës lokale Ramoc-Korenicë	Komuna Gjakovë	"ARFA GROUP" sh.p.k.	Kontraktuar: 16.11.2012 Përfunduar: 14.05.2019	382,671.96
17	Asfaltimi i rrugëve në Deçan(Fshati Pozhar, Patriot Berisha, Lumbardh " Rexhë Kaqorraj, Llukë e Eperme, Riza Sadikëve, Maznik, të shkolla Rastovicë) në vazhdim	Kuvendi Komunal Deçan	"ARFA GROUP" sh.p.k.	Kontraktuar: 04.10.2018 Përfunduar: 05.09.2019	903,650.06
18	Asfaltimi i disa rrugëve dhe rrugicave në fshatin Broliq në komunën e Pejës	Komuna Pejë	"ARFA GROUP" sh.p.k.	Kontraktuar: 05.09.2017 Përfunduar: 18.09.2018	140,353.00
19	Zgjerimi i rrugës Nacionale N25, segmenti: Suharekë – Korishë, L=1,270.20m	Ministria e Infrastrukturës	"ARFA GROUP" sh.p.k.	Kontraktuar: 09.08.2016 Përfunduar: 07.12.2018	806,946.25

**Në Total: 3,920,810.37**

- Sa i përket kërkesës 4 dhe 8 lidhur me përvojën e punës së stafit profesional nuk qëndron sepse si menaxheri, udhëheqësi dhe inxhinieri i komunikacionit kanë CV të nënshkruar nga inxhinieri, diplomat e noterizuar, kontratat e punës me ofertuesin të noterizuar dhe letër referencat adekuate që dëshmojnë që kanë realizuar punë të ngjashme.
- Pika 9 listat e pagave nuk qëndron për faktin se kemi dorzuar listen e pagave të punëtorëve sipas kërkesës në FTD me nënshkrim dhe vulë nga banka.
- Sa i përket pikës 10 po ashtu nuk qëndron sepse kemi marrëveshjen për huazim të mjeteve nga "COMPANYA ESKAVATORI" SH.P.K. lista përputhet me kërkesat e vendosura nga AK në FTD, dhe në listën e mjeteve në një kolonë



janë të cekura për secilin mjet se cilës kompani i takon mjeti dhe mjetet që janë të huazuara nga "COMPANYA ESKAVATORI" SH.P.K.

- AK nuk ka specifikuar se për cilat mjete bëhet fjalë.

Ju sqarojmë se ne i plotësojmë të gjitha këto kërkesa si në dosjen e tenderit ashtu edhe tek njoftimi për kontratë, por nëse AK ka pasur dyshime në ofertën tonë atëherë dilemat dhe mungesat eventuale që mund ti ketë pasur me rastin e vlerësimit, ka mundur ti sqaroi sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, e sidomos këto dispozitat duhet të përdoren në rastet për ruajtjen dhe kursimin e buxhetit. Përfundimisht mendojmë se AK ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit pa mbështetje ligjore dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 62 të LPP-së dhe me dispozitat e nenit 44.5 të RrUOPP.

#### 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

#### 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informata të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues